



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 40.2 nën h) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 40 paragrafi 2 nën pikën 7) të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 3 pika 4 nën pika 4.2 dhe nenit 5 të Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera nr.01-06-4414/2015, me Propozimin e Kryetarit të Komunës nr.01-644-2934/2016 të dt.17.06.2016, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të radhës për vitin 2016, mori këtë:

V E N D I M

Për dhenjen e Titullit "NDERI I QYTETIT" të Klinës
personaliteteve të shquar dhe kontributdhenës për shtetformimin e
Republikës së Kosovës

- I. Jepet Titulli "NDERI I QYTETIT" personaliteteve të Shqyera dhe kontributdhenës në shtetformimin e Republikës së Kosovës për vitet 1980- 1990-ta, Ish Deputeteve të Kuvendit të Kosovës nga Komuna e Klinës:
 - 1.Bajram Buqani-Dollovë
 - 2.Hysen Bashota -Caravik
 - 3.Halil Maxharraj-Gremnik
 - 4.Nikollë Shabanaj –Krushevë e Vogël
 - 5.Halit Kryeziu –Klinë
- II. Titulli si në pikën 1 të këtij vendimi përbehet nga pllaketa dhe fletëmirnjohja.
- III. Vendimi është i plotfuqishëm më miratimin e tij nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas protokollimit dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL.

Më këtë vendim të njoftohen:

- MAPL
- Kryetari i Komunës
- Kryesuesi i Kuvendit
- Zyra e Informimit
- Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe
- Arkivi i Komunës së Klinës

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-3049 2016
Klinë, më 29.06.2016

